

"ISHA BULLIZUES"

i Andrea Franzosos

SKEDA 5

KAPITULLI 13-14-15

"Ditelindje ne burg"

Danieli mbush 18 vjeç. Bëhet 'i rritur' në burg dhe me siguri nuk është kjo festa që kishte menduar të organizonte. Por nuk i mungojnë surprizat. Para së gjithash, e ëma, e cila i thotë diçka shumë të bukur. A e mban mend se çfarë i thotë? Si reagon Danieli?

.....

.....

.....

Për pjesën tjetër, Danieli mendon se të gjithë e kanë harruar. Përkundrazi, sheh fishekzjarre jashtë dritares: çfarë është?

.....

.....

.....

"Danieli qëndroi për një kohë të gjatë në dritare. Ndjeu një lëshim emocionesh brenda tij". Cilat janë këto emocione? Përpiqu t'i imagjinosh.

Fjalët janë të rëndësishme

1. Danieli thotë disa herë se i mungojnë fjalët për të shprehur veten. Pra, ai përdor këngë, ose krahasime, ose përafrime (domethënë, përpiqet që t'i afrohet konceptit që dëshiron të shprehë me fjalë të tjera). Le të marrim një shembull. Një vajzë e braktisur nga i dashuri i saj thotë: "Ndihem thellësisht e lënduar dhe e zhgënjyer". Si mund ta thoshte të njëjtën gjë me një krahasim ose me një metaforë?

"Jam, është sikur"

.....

.....

Dhe me një përafrim, domethënë, duke përdorur fjalë që janë më të lehta për ty, por që nënkuptojnë pak a shumë të njëjtën gjë?

.....

.....

Po me një këngë? A shprehet kjo gjendje shpirtërore në ndonjë nga këngët që ti njeh? Si? Nëse jo, përdor këngën e cituar në fillim të kap. 14 të librit.

.....

.....

2. Danieli konsiderohet një djalë "cattivo", që në shqip do të thotë "i keq". A e dini etimologjinë e kësaj fjale? Termi "cattivo" vjen nga një term latin që do të thotë "i burgosur". I burgosur i kujt apo i çfarë? Reflektoni dhe diskutoni në klasë.

3. Të kesh një fjalor të pasur, domethënë të dish shumë fjalë, të mundëson të emërtosh shumë gjëra dhe t'i kuptosh ato. Për shembull, me foljet "pëshpërit, përgjigjem, ngulmoj, këmbëngul, përgjrohëm, shpërthej, thërras, bërtas, belbëzoj, etj.", mund të përshkruaj me saktësi mënyrën se si flet një person, duke dhënë shumë më tepër informacion sesa thjesht "them". Çfarë sugjeron Serafina të bëjmë për të pasuruar fjalorin tonë?

.....

.....

.....



Përcaktimi i ndjenjave

1. PËRMALLIMI: një emocion i këndshëm aq i fortë sa na bën të qajmë. Në cilat situata përmallohemi? E fshih apo nuk të shqetëson nëse e tregon këtë emocion?

.....

.....

.....

2. PAKËNAQËSIA: është qëndrimi i një personi që nuk mund ta durojë një situatë, shfaqet me nervozizëm, me një tërbim të mbajtur. A e mban mend se për çfarë është veçanërisht i pakënaqur Danieli?

.....

.....

.....

DEBAT:

PSIKOLOGU, NJË HAPËSIRË DËGJIMI

Serafina është psikologja e burgut. Një herë në javë Danieli flet me të për një orë të tërë. Ajo orë është "një hapësirë dëgjimi ku mund të hapesh pa frikën se do të gjykoresh"; Serafina e bën të ndihet rehat Danielin, e lë të flasë, e ndihmon të rregullojë mendimet e tij, i jep disa këshilla.

Herë pas here të gjithë kemi nevojë të shfryjmë, të themi çfarë na vjen në mendje, t'i qartësojmë gjërat. Mund ta bëjmë me një mik, një anëtar të familjes sonë apo edhe me një psikolog. Çfarë kontributi të veçantë mund të japë një ekspert në këto raste? Filloni një debat në klasë mbi këtë temë.

NDJENJA: MIQËSIA

Psikologja i thotë Danielit se lidhja me Maksimin e shpëtoi, sepse “tek ai gjete dikë që të respektonte, që të donte ashtu siç ishe pa të gjykuar”. Domethënë, një mik.
A je dakord me këtë përkufizim? Çfarë është një mik për ty? Mundohu të përshkruash se çfarë pret prej tij. Një mik është....
Fjala shok dhe mik, a mund të përdoren si sinonime të njëra-tjetrës? Cilat janë gjërat e përbashkëta dhe ndryshimes mes tyre?

“Miqësia juaj ka qenë për ty gjithmonë një vend i sigurt, një hapësirë e shenjtë ku kishit mundësi të bashkëndanit nevojat dhe aspiratat tuaja, madje edhe plagët tuaja”. Si e imagjinon këtë vend? A është një dhomë, një kuti e madhe, një shtëpi, një shpellë, një pemë për t'u ngjitur? Përpigu ta përshkruash.

Të rriturit: TË RRRITUR TË BESUESHËM

DOM KLAUDIO, kapelani mirëpritet nga të burgosurit në një mënyrë të veçantë: si?

Danielit menjëherë i bie në sy fytyra e Dom Klaudios. Kërko në tekst se cilët mbiemra autori zgjedh të përshkruajë

sytë:

zërin:

buzëqeshjen:

Çfarë ndjesish provon Danieli?

Ngrohtësi

Dashuri

Bezdi

Cila është karakteristika kryesore e Dom Klaudios? Çfarë e bën atë të ndryshëm nga shumë të rritur të tjerë dhe e bën të besueshëm në sytë e djemve?

NJË KOMUNITET I VEÇANTË

Për djem si Danieli, të cilët arrestohen dhe dënohen pas një gjyqi, burgu nuk është e vetmja zgjidhje. Janë edhe komunitetet, ku zhvillohen aktivitete dhe zejtari të ndryshme, djemtë studiojnë, luajnë sporte, hanë dhe flenë. Nga komunitetet edhe mund të dilet (por duhet të merresh vesh me përgjegjësit), domethënë nuk je i mbyllur si në burg; po ashtu, familjarët e djemve mund të hyjnë e të dalin. Danieli njeh tri komunitete, mes të cilëve Il Sorrizo di Kastrono dhe Kajrosin.

1. Pse Danielit nuk i pëlqen Komuniteti Il Sorrizo? Cila nga rregullat e mëposhtme është ndalimi që e konsideroni më pak të dobishëm ose më pak të këndshëm?

2. Pse Danieli ikën nga Komuniteti Il Sorrizo dhe Komuniteti Providenca e Arcos?

3. Cilat janë detajet që i bien menjëherë në sy Danielit kur ai mbërrin në Komunitetin e Kajrosit? Pse, në një moment të caktuar, ai thotë: “Këtu qenka Parajsë”?

4. Djemve të komunitetit u lejohet të dalin: gjatë dy mbrëmjeve të përshkruara mund të bëjnë atë që do të bënte çdo djalë. A mendon se kjo është e rëndësishme? Pse? Çfarë i bën përshtypje Danielit në sjelljen e Dom Klaudios?